

VENDIM
Nr.765, datë 24.9.2010

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.53, DATË 21.1.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR NGARKIMIN E MINISTRISË SË BRENDSHME PËR KRYERJEN
E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË
KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË, PËR DISA
MALLRA DHE SHËRBIME”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 11 të ligjit nr.9643, datë 21.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të pikës 1 të vendimit nr.53, datë 20.1.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Përjashtimisht, lejohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, t’i realizojë vetë procedurat e prokurimit për arredimin me pajisje elektronike dhe orendi të Akademisë Tatimore e Doganore.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha